



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.02.2024

Nr: 8

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIM E KËRKESËS ANKIMORE NR. 1, DATË 04.01.2024, DEPOZITUAR NGA
“PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË”, NR. 3, DATË 08.01.2024
DEPOZITUAR NGA “PARTIA G99” DHE NR. 4, DATË 29.12.2023 DEPOZITUAR NGA “PARTIA
ALEANCA POPULLORE”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.02.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES:

1. Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë
2. Partia G 99
3. Partia Aleanca Popullore

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe

Data: 12.2.2024 Nr: 8
Ora: 12:00



Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, nr. 3, datë 08.01.2024 depozituar nga “Partia G 99” dhe nr. 4, datë 29.12.2023 depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”

shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Në mbështetje të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 10, datë 21.4.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, dhe mënyrën e pagesës së audituesve”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi 46 (dyzet e gjashtë) nga 132 (njëqind e tridhjetë e dy) raporte financiare të dorëzuara nga partitë politike. Nga shqyrtimi i raporteve, u konstatua se 86 (tetëdhjetë e gjashtë) parti politike, ndër të tjera edhe Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë që nuk kanë dorëzuar raport financiar vjetor për vitin 2021.
3. Me vendimin e tij nr. 823, datë 07.12.2023, “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”, ka marrë masë administrative 103 (njëqind e tre) subjekte zgjedhore. Për 89 (tetëdhjetë e nëntë) subjekte vendosi masë administrative sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit “Për Partitë Politike” dhe për 14 (katërmbëdhjete) subjekte vendosi masë administrative sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike”. Ndër të tjera vendosi, si vijon:
 - **63. Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia G99”, me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit “Për Partitë Politike”.**

Data: 12.2.2024 Nr: 8
Ora: 12:30



Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, nr. 3, datë 08.01.2024 depozituar nga “Partia G 99” dhe nr. 4, datë 29.12.2023 depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”

- **96. Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike”.**
- **101. Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Aleanca Popullore”, me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike”.**

4. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur kërkesa ankimore të regjistruara me nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, nr. 3, datë 08.01.2024, depozituar nga “Partia G 99” dhe 4, datë 29.12.2023, depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”. Seancat paraprake për kërkesat ankimore u zhvilluan më datë 12.01.2024.
5. Kërkesat ankimore kundërshtojnë vendimin nr. 823, datë 7.12.2023 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”. Duke qenë se kërkesat ankimore kanë njëtin objekt, KAS vendosi të shqyrtohen bashkërisht, me relator z. Koli Bele.
6. Seanca e shqyrtimit u zhvillua më datë 12.02.2024, me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të administratës së KQZ-së.
7. Gjatë seancës së shqyrtimit mori pjesë subjekti “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, përfaqësuar me autorizim nga z.Pal Shkambi.
8. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kërkoi t’i qëndrojë vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Përfaqësuesi i pranishëm i subjektit “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, kërkoi rrëzimin e vendimit nr. 823/2024 të KSHZ.

Data: 12.2.2024 Nr: 8
Ora: 12:30



Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, nr. 3, datë 08.01.2024 depozituar nga “Partia G 99” dhe nr. 4, datë 29.12.2023 depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”

9. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”
- Kërkesën ankimore nr. 3, datë 08.01.2024, depozituar nga “Partia G99”
- Kërkesën ankimore nr. 4, datë 29.12.2023, depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”
- Vendimi nr. 823, datë 7.12.2023 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
- Raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organi kompetent për të vendosur sanksione administrative ndaj partive politike në lidhje me mosdorëzimin e pasqyrave financiare të Partive Politike sipas nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23, 23/2 dhe 23/4, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, të ndryshuar.
2. Neni 23, i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, parashikon se partitë politike kanë detyrimin të dorëzojnë raportin financiar 1 (një) herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky raport duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
3. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve KAS konstaton se, për vitin kalendarik 2021 janë të regjistruara në total 132 (njëqind e tridhjetë e dy) parti politike në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të cilët janë të detyruar të dorëzojnë raportin financiar konform ligjit. Nga këto vetëm 46 (dyzet e gjashtë) parti politike e kanë dorëzuar raportin financiar për vitin kalendarik.

Data: 12.2.2024 Nr: 8
Ora: 12:30



Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, nr. 3, datë 08.01.2024 depozituar nga “Partia G 99” dhe nr. 4, datë 29.12.2023 depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”

4. KSHZ me vendimin nr. 823, datë 07.12.2023, "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021", ka marrë masë administrative 103 (njëqind e tre) subjekte zgjedhore. Për 89 (tetëdhjetë e nëntë) subjekte vendosi masë administrative sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit "Për Partitë Politike" dhe për 14 (katërmbëdhjete) subjekte vendosi masë administrative sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit "Për Partitë Politike". Ndër të tjera vendosi, si vijon:

- **63. Marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia G99", me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit "Për Partitë Politike".**
- **96. Marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit "Për Partitë Politike".**
- **101. Marrjen e masës administrative, për partinë politike "Partia Aleanca Popullore", me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 2 të ligjit "Për Partitë Politike".**

5. Subjekti "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", nëpërmjet përfaqësuesit të saj ngriti pretendimin se është kontaktuar nga eksperti kontabël dhe ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar. Subjekti politik deklaroi se ka sqaruar audituesin se nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet politik apo financiar që prej vitit 2017 dhe për rrjedhojë nuk ka disponuar asnjë dokumentacion tjetër, përveç pasqyrave financiare me vlerë 0 (zero) dhe deklaratës së subjektit politik, të cilat ia ka dorëzuar eksperti kontabël. Duke qenë se subjekti politik nuk ka kryer asnjë shpenzim dhe nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga asnjë burim financiar publik apo privat, ka pasur statusin pasiv pranë organeve tatimore.

Në vlerësim të pretendimeve të ngritura nga ky subjekt krijohet bindja se nuk jemi para rrethanave të parashikuara nga neni 23/4, pika 2 e ligjit "Për Partitë Politike", pasi subjekti është treguar i gatshëm për të bashkëpunuar me KQZ-në. Në këtë rast kemi të bëjmë me mospërbushjen e detyrimit që rrjedh nga neni 23/4, pika 1 e ligjit "Për Partitë Politike".

Data: 12.2.2024 Nr: 8
Ora: 12:30



Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", nr. 3, datë 08.01.2024 depozituar nga "Partia G 99" dhe nr. 4, datë 29.12.2023 depozituar nga "Partia Aleanca Popullore"

6. Subjekti "Partia G99", me kryetar z. Redi Shtino, në ankimimin e tij ngre pretendimin se prej datës 26.06.2019, statusi i partisë politike pranë organeve fiskale është pasiv. Ndodhur në këto kushte, nuk ka deklaruar asnjë të ardhur. KAS, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti Partia G99 vlerëson se, pavarësisht "analogjisë së supozuar" të partisë politike si subjekt juridik, me shoqëritë të cilat zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe që këto të fundit në kuptim të legjislacionit fiskal mund të kalojnë në "status pasiv", ligji për partitë politike nuk parashikon "status pasiv" për subjektin politik. Ligjvënësi në nenin 20 ka përcaktuar se "Ndalohet krijimi i personave juridikë tregtarë e jotregtarë, që ushtrojnë veprimtari me qëllim fitimi, nga partitë politike apo nëpërmjet të tretëve"..., duke qartësuar se partitë politike janë subjekt juridik i posaçëm që nuk ka qëllim fitimin. Neni 23 i ligjit për Partitë Politike, përcakton se çdo parti ka detyrimin të dorëzojë raportin financiar 1 (një) herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nga ky parashikim nuk përjashtohen partitë politike, NIPT-i i të cilave ka kaluar në statusin pasiv. Në këto kushte, ndodhemi përpara faktit se është shkelur neni 23/4, pika 1 e ligjit "Për Partitë politike".
7. Subjekti "Partia Aleanca Popullore", në ankimimin e tij ngre pretendimin se për shkak të statusit pasiv të partisë në vitin 2021, dorëzimi formal i një raporti financiar në këto kushte nuk sjell asnjë dobi. Në këto kushte i njëjti arsyetim si më sipër vlen edhe për këtë subjekt politik, duke qenë në mospërbushjen e detyrimit që rrjedh nga neni 23/4, pika 1 e ligjit "Për Partitë Politike".
8. Lidhur me kualifikimin e shkeljes si dhe sanksionin e vendosur për subjektet "Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë", dhe "Partia Aleanca Popullore", KAS vlerëson se për këto subjekte që kanë paraqitur ankim, nuk jemi para kushteve dhe rrethanave të parashikuara nga neni 23/4, pika 2 e ligjit "Për Partitë Politike", pasi raportet e auditeve si dhe vendimmarrja e KSHZ, nuk provojnë mungesën e pretenduar të bashkëpunimit për subjektet politike të sanksionuara sipas këtij neni, por jemi para kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 23/4, pika 1 të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë” dhe kërkesës ankimore nr. 4, datë 29.12.2023, depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”.
2. Ndryshimin e pikës nr. 96 dhe nr. 101, të vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke vendosur sanksionin administrativ gjorbë, në vlerën 60.000 lekë, sipas nenit 23/4, pika 1, të ligjit “Për Partitë Politike”.
3. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 3, datë 08.01.2024, depozituar nga “Partia G 99”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot, më datë 12.02.2024.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Data: 12.2.2024 Nr: 8
Ora: 12:30



Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 1, datë 04.01.2024, depozituar nga “Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë”, nr. 3, datë 08.01.2024 depozituar nga “Partia G 99” dhe nr. 4, datë 29.12.2023 depozituar nga “Partia Aleanca Popullore”